



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME**  
**Komiteti për Politikë dhe financa**  
Nr.01-060/01-12831/24 datë: 22.05.2024



Npi – 01/188 datë: 27.05.2024

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008); Si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/155 datë: 27.04.2023, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 27.05.2024 nxjerr këtë:

**E K S T R A K T**  
**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË -V- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA**  
E mbajtur më datën: 27.05.2024 (e hënë) në ora 13:30 h. në sallën e vogël të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, Anëtarët e Komitetit: z.Përparim Ramusa, z.Lumni Amrush, znj.Adelina Beqaj, znj.Saniye Sadiki, znj.Zejnije Veliu dhe z.Kadri Emini. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje ka marrë pjesë edhe: z.Besnik Ahmeti drejtor i DBF; z.Grejtalb Emini drejtor i DPUKGGJ; Nga zyra e informimit znj.Vlora Hyseni, dhe znj.Gentiana Mehmeti asistente e Kryesuesit të Kuvendit; Mbledhjen e hapi, Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

**REND DITE**

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 26.04.2024,
2. Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2025-2027, (për diskutim publik)
3. Propozim-Vendim për dhënjën në shfrytëzim të pronës komunale pjesën e N.K me Nr.1404-11 ZK-Shtime me sipërfaqe 8000 m<sup>2</sup> Operatorit të Sistemit dhe Transmisionit dhe Tregut SH.A-KOST-it,
4. Propozim-Vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm të N.K. Nt.1893-0 me sipërfaqe prej 341m<sup>2</sup> , Z.K-Shtime,
5. REKOMANDIM për Kuvendin i Komisionit për ndarjen e qmimit 'Nderi Qytetit'

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimin për rendin e ditës.

**z.Kadri Emini;** Përshëndetje, në KPF-ë pikat e rendit të ditës po na vinë jo në harmoni me pikat e Kuvendit pse?

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Katër pika prej tyre janë, propozim-vendime vetëm për sa i përket përmirsimit të bazës ligjore, dy pika janë Informata për Kuvend dhe një është pyetje përgjigje e të cilat nuk kanë nevojë me kaluar edhe në KPF-ë.

**\*Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 26.04.2024

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**\*Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 26.04.2024.**

## Pika 2

### Draft-Korniza Afatmesme Buxhetore Komunale 2025-2027, (për diskutim publik)

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Fjalën ja dha z.Besnik Ahmeti.

**z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF;** Përsëndetje, më datën 15.05.2024 na ka ardhur Qarkorja Buxhetore 2025-27, ne jemi duke bërë përpjekje që ta përfundojmë dokumentin final të Qarkores por ende jemi duke punuar, unë po besoj se për seancën e Kuvendit më 29.05.2024 do ta kompletojmë. Shuma e përgjithshme e buxhetit për vitin 2025 është paraparë të jetë 10.777.180 euro. Në vazhdim e sqaroi në pika kryesore, (shih dokumentin). KAB-i sipas ligjit duhet me shku në diskutim publik, prandaj unë ju ftoj që ta merrni këtë vendim dhe pastaj do të kemi mundësinë që të diskutojmë për te.

**z.Përparim Ramusa;** Përsëndetje, ne sigurisht që jemi për me shku në diskutim publik, mirëpo vërejtja ime është se te pika më e rëndësishme, dhe mos me na ardhur në mbledhje me kohë drejtorat është shqetësuese.

**z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF;** E vërtetë por është më mirë me e analizuar më detaisht, dhe tjetra kjo ka me shkuar në diskutim publik.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Drejtori tha se subvencionet kanë me shkuar nga 350.000 euro deri në 500.000 euro.

**z.Përparim Ramusa;** Pse ka me ndodhë kjo rritje te kategoria paga dhe mëditje?

**z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF;** Për arsye se pritet rritja e numrit të puntorëve, pastaj edhe rritja e koeficientit etj.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Konstatoj Kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

**\* Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Vendimit për ta nxjerrë në diskutim publik Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore Komunale 2025-2027, me vërejtjen që materiali me ardhë për Kuvend.**

## Pika 3

### Propozim-Vendim për dhënjën në shfrytëzim të pronës komunale pjesën e N.K me Nr.1404-11 ZK-Shtime me sipërfaqe 8000 m<sup>2</sup> Operatorit të Sistemit dhe Transmisionit dhe Tregut SH.A-KOSTT-it

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Fjalën ja dha z.Grejtalb Emini.

**z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ;** Shtimja është përfituese e realizimit të një projekti të ndërtimit të Nënstacionit të ri Energjetik NS 110 /35/10 (20) KV të rrymës elektrike edhe për energjin e ripërtrishme. Kështu pra e kemi një kërkesë nga KOSTT-i për nderjen e 80 ari sipërfaqe për tua dhënë për këtë qëllim. Ne e kemi sjellë kërkesën e tyre për ta shqyrtuar Kuvendi. Ajo që mund të themi është se përfitimet janë të shumëfishta. Unë ju ftoj që ta miratoni këtë vendim. Nëse ka ndonjë pyetje do të përgjigjem, materialin e keni marrë me kohë dhe besoj e keni lexuar.

**z.Përparim Ramusa;** Ne nuk kemi arsye me e refuzuar këtë kërkesë ne jemi "Pro".

**z.Lumni Amrushi;** Unë e kam një pyetje se ka ndonjë plan se kur fillon e kur përfundon ky projekt dhe kush ka me u furnizuar me këtë energji, Komuna e Shtimes apo më gjerë.

**z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ;** E di vetëm se këtë vit ka me filluar, trafostacioni prej 110 KW është furnizues për krejt teritorin e Komunës së Shtimes. Siç e dini kemi problem me energjinë elektrike gjithandej nëpër fshatra e rrafshit edhe më gjerë.

**z.Kadri Emini;** Plani Zhvillimor a e atakon dikund ndërtimin e këtij stacioni elektrik?

**z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ;** Jo nuk e kemi problemin me planin zhvillimor, aty faktikisht veq po zgjerohet ajo parcelë ku janë tani të vendosur KEDS-i.

**znj.Adelina Beqaj;** Falënderit drejtor po më pëlqen kjo e kam pa edhe SFOT- analizën. Te qiraja duhet me u cekë ne vendim. Pyetja është sa është vlera e këtij projekti?

**z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ;** Sa i përket pagesës u pajtuam që të jetë pa pagesë, atëherë për vlerën e projektit tani nuk e di por mund ta marrë informatën.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Konstatoj kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

\* Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Vendim për dhënjen në shfrytëzim për 99 vjet, pronën komunale pjesën e N.K me Nr.1404-11 ZK-Shtime me sipërfaqe 8000 m<sup>2</sup> Operatorit të Sistemit dhe Transmisionit dhe Tregut SH.A-KOSST-it.

#### Pika 4

Propozim-Vendim për shpalljen me interes të përgjithshëm të N.K. Nt.1893-0 me sipërfaqe prej 341m<sup>2</sup>, Z.K-Shtime

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Fjalën ja dha z.Grejtalb Eminit.

**z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ;** Propozimi ynë ka të bëjë me rreth 3 ari sipërfaqe të pronës private që duhet me i shpronsuar me qëllim që ta bëjmë një rrethrotullim te kryqëzimi i rrugëve "Skender Salihaj" me rrugën "Mic Sokoli" që duhet të zgjerohet si dhe rruga "Komandant Kumanova". Kjo është bërë e domosdoshme për shkak të shtimit gjithëherë e më shumë të dendësisë së komunikacionit si dhe ndërtimeve të larta. Ju ftoj që ta miratoni. Nëse ka ndonjë pyetje.

**z.Kadri Emini;** A keni bërë ndonjë parallogari?

**z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ;** Jo nuk na lejohet, sepse vlerësimin e bënë komisioni i Ministrisë.

**znj.Adelina Beqaj;** Meqenëse e përmende palën, a bën me pas një deklaratë të palës për pronën e tijë.

**z.Përparim Ramua;** A po e kërkon pronën për rrethrotullim apo për zgjerimin e rrugës "Mic Sokoli" ? Dhe e dyta a keni ndonjë premtim nga Ministria për këtë projekt?

**z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ;** Shpronsimi do të bëhet për zgjerimin e rrugës "Mic Sokoli".

**z.Përparim Ramusa;** Unë te kjo pikë kamë me "Abstenu" njëher kemi me bisedu me Fadilin. Krejt jemi dakort që me u zgjeru ajo rrugë.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Konstatoj kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

\*Komiteti për Politikë dhe Financa, me 3 vota "Për" (4 vota "Për" me votën e dyfishtë të Kryesuesit sipas nenit 48.1 të LVL-së) me 0 vota "Kundër" dhe me 3 vota "Abstenu" vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm të N.K. Nt.1893-0 me sipërfaqe prej 341m<sup>2</sup>, Z.K-Shtime.

#### Pika 5

Propozim-Vendim për ndryshimin e bazës ligjore të Vendimit të KK-së me numër Npi – 01/118 datë: 28.03.2024

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Hapi diktutimin për këtë pikë.

**z.Përparim Ramusa;** Unë jam anëtarë i Komisionit dhe ne si Komision kemi mbajtur mbledhje dhe Kryetari ka propozuar 5 anëtarë që të marrin këtë çmim. z.Abdyl Hajredini, ka propozuar që ti ndahet vetëm një personi çmimi "Nderi i Qytetit".

**znj.Adelina Beqaj;** Mua po më pëlqen propozimi i z.Abdyl Hajredinit që vetëm një person me marrë çmimin sepse pastaj dalin kërkesa të tjera pse jo 7 pse jo 8 etj. Unë mendoj se më mirë është me shku me një propozim.

**Kryesuesi, z.Adnan Ademi;** Konstatoj kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje.

\*Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Vendimit, për ndarjen e çmimit 'Nderi i Qytetit' sipas Rekomandimit të Komisionit Npi-01/167 të datës 23.05.2024, që çmimi "Nderi i Qytetit", të Komunës së Shtimes, ti ndahet grupit të plejadës të doktorëve të suksesshëm, që e avansuan shëndetësinë e Komunës së Shtimes në rrafshin kombëtar dhe ndërkombëtar, si vijon: Dr.Rifat Bajrami – Carralevë, Dr.Hysni Arifi – Belinc, Dr.Sami Salihu – Mollopolc, Dr.Isa Haxhiu – Rashincë, Dr.Vezir Bajrami – Reçak, (Post mortum)

Meqenëse diskutime tjera nuk kishte mbledhjen Kryesuesi e përfundoi në ora 14:39h.

Procesmbajtësi  
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i KPF  
Adnan Ademi

